

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11) si dhe në bazë të nenit 22 dhe nenit 25 të Ligjit për arsimin e mesëm ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30 / 2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/18) Ministri i Arsimit ka miratuar një program mësimorë të shkurtuar për lëndën mësimore Histori për vitin III- të në arsimin e mesëm profesional katërvjeçarë

1. HYRJE

Programi i shkurtuar për lëndën mësimore HISTORI është i bazuar në qëllimet e vendosura nga programi mësimorë i lëndës i cili realizohet në mënyrë të rregullt në përputhje me planin e miratuar mësimor.

Programi i shkurtuar përcakton tema të caktuara dhe njësi mësimore që duhet të realizohen në 159 ditë mësimore, me ë' rast e respektohet fondi javor i orëve i përcaktuar me programin e rregullt , respektivisht realizimin e lëndës me 2 orë në jave ose 64 orë në vit me programin e shkurtuar.

Mësimdhënësi në planifikimin dhe realizimin e njësive mësimore nga programi i shkurtuar bazohet në qëllimet , nocionet, metodat dhe aktivitetet e parashtruara të programit të rregullt mësimor.

Qëllimet e mësimdhënies së historisë në arsimin e mesëm profesional katërvjeçarë janë që nxënësit të marrin njohuri thelbësore, të sistemuara, të përhershme dhe të konfirmuara shkencërisht nga e kaluara dhe e tashmja, të kontribuojnë në mendimin kritik dhe zgjimin e vetëdijes historike, duke ndërtuar një sistem të vlerave të sjelljes ndaj popullit dhe vendit të tyre , dhe ndaj popujve dhe vendeve tjera drejt drejt asaj që është një arritje civilizuese në botë, si dhe për të thelluar interesin për studimin e mëtejshëm të ngjarjeve dhe proceseve historike.

2. Pasqyrë e temave dhe njësive mësimore

Tema : Parahistoria $4 + 2 = 6$

Tema përpunohet me 4 orëve mësimore për përmbajtje të reja + 2 ore dhe ushtrime dhe përsëritje. Ora është planifikuar të zgjasë 30 minuta

Përmbajtja :

1. Koha e gurit
2. Koha e metaleve
3. Maqedonia në parahistori

Tema : Koha e vjetër $11 + 7 = 18$

Tema përpunohet me 4 orëve mësimore për përmbajtje të reja + 2 ore dhe ushtrime dhe përsëritje. Ora është planifikuar të zgjasë 30 minuta

Përmbajtja :

1. Qytetërimet më të vjetra
2. Shteti i vjetër hebrait
3. Helada
4. Sparta dhe Athina

5. Kultura Heladës
6. Popujt e ballkananit
7. Origjina e shtetit romak
8. Luftërat e brendshme në shtetin romak
9. Krishterimi në Shtetin romak

Tema : Mesjeta 11 + 7 = 18

Tema përpunohet me 11 orëve mësimore për përmbajtje të reja + 7 ore dhe ushtrime dhe përsëritje. Ora është planifikuar të zgjasë 30 minuta

Përmbajtja :

1. Evropa para migrimit të madh të popujve
2. Evropa dhe jeta e saj në Mesjetë
3. Roli i religjionit në mesjetë
4. Kultura në mesjetë
5. Ndryshimet socio-ekonomike në mesjetën e zhvilluar dhe të vonë
6. Krijimi i shteteve të reja në Ballkan
7. Shteti osman
8. Rënia e shteteve ballkanike nën sundimin osman

Tema : Koha e re 10 + 6 = 16

Tema përpunohet me 10 orëve mësimore për përmbajtje të reja + 6 ore dhe ushtrime dhe përsëritje. Ora është planifikuar të zgjasë 30 minuta

Përmbajtja :

1. Qytetaria në luftën për të drejtat e reja politike
2. Revolucioni i madh francez
3. Ngritja e Demokracisë Evropiane
4. Kultura në Evropë në gjysmën e dytë të shekullit XIX
5. Zhvillimi i qytetarisë në vendet e Ballkanit
6. Filli i lëvizjes nacionalçlirimtare tek popujt ballkanikë nën sundimin osman në fillim të shekullit XIX
7. Migrimet dhe emigrimet nga fundi i shekullit XVIII në Luftën e Parë Botërore

Tema : Koha e fundit 4 + 2 = 6

Tema përpunohet me 4 orëve mësimore për përmbajtje të reja + 2 ore dhe ushtrime dhe përsëritje. Ora është planifikuar të zgjasë 30 minuta

Përmbajtja

1. Kundërthëniet në Luftën e Parë Botërore
2. Shkenca dhe kultura midis dy luftërave botërore
3. Lufta e Dytë Botërore

1. Rekomandimet didaktike

Mësimdhënësi mundet t'i zbatojë të gjitha metodat dhe teknikat mësimore të verifikuara në përputhje me qëllimet e definuara. Rekomandohet forcimi i sistemit të metodave problemore dhe krijuese , analitike-interpretative dhe integruese korelative. Mësimdhënësi duhet të iniciojë aktivitete të pavarura të nxënësve, t'i udhëheqë drejt mësimi të menduar receptive dhe të menduarit aktiv dhe ta korigjojë mësimin mekanik- receptive dhe mekanik aktiv.

Gjatë realizimit të programit të shkurtuar në lëndën mësimore në lëndën HISTORI të detyrueshëm për vitin III-të, mbështetja themelore është programi i rregullt mësimorë (qëllimet konkrete, nocionet, aktivitetet dhe metodat e propozuara). Për realizimin e këtij programi nevojitet planifikimi i integruar respektivisht ndërlidhja e qëllimeve dhe përmbajtjeve si dhe planifikimi i mësimi me ndërlidhjen e mësimnxënies me përvojat e nxënësve. Për realizimin e lëndës mësimore, duhet të zbatohen forma dhe metoda interactive (teknika e mësimi dhe aktivitet). Nga metodat interaktive do zbatohet puna me grupe, diskutime, stuhi mendimesh, analiza e teksteve dhe dokumenteve, studim rasti, por edhe metoda tradicionale: ligjërata të shkurtëra dhe biseda të fokusuara. Rekomandimet për përdorimin e fondit të shkurtuar të orëve janë të dhëna si orientim së bashku me qëllimet dhe temat konkrete/ përmbajtjet shpërdarja e të cilave nuk është e kufizuar por mësimdhënësit i jepet hapsirë që shpërndarjen ta bëjë në përputhje me e ndryshme të cilat paraqiten gjatë realizimit.

Nxënësi duhet vazhdimisht të nxitet dhe motivohet që mësimin ta ndjekë në kontinuitet dhe në mënyrë aktive në përvetësimin e përmbajtjeve të reja , në zhvillimin e mendimit kritik gjatë të mësuarit, në zhvillimin e mundësive dhe aftësive të cilat janë të rëndësishme qenësore për ardhmërinë e jetës së tij.

Me rastin e shpërdarjes respektivisht rradhitjes së orëve lejohet kreativiteti dhe elokuenca e mësimdhënësit në realizimin e qëllimeve mësimore.

Kontrollimi i diturive të nxënësve realizohet në të gjitha fazat e procesit mësimor respektivisht, gjatë realizimit të përmbajtjes së re mësimore, gjatë përsëritjes, kontrollimit, sistematizimit, ushtrimeve dhe hulumtimit. Kontrollimi realizohet me teknika të ndryshme për punë; me tekste historike, material ilustrues, analizë të pavarur të teksteve historike dhe ilustrimeve, interpretimi i dokumenteve historikedhe vlerësimi i interpretimeve të ndryshme. Gjatë ndjekjes dhe notimit zbatohen mënyra të ndryshme (kontrollimi me gojë dhe me shkrim, teste të diturisë, përpilimi i punëve seminarike, referate, aktivitete të nxënësve në orë mësimore etj.)

Mësimdhënësi do të përdorë mjete mësimore të cilat janë të përcaktuara me programin e rregullt mësimor.

4. Normativi për kuadrin mësimorë

Programin e shkurtuar mësimorë e realizon mësimdhënësi në pajtim me normativin për kuadrin mësimorë të përcaktuar në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimorë për lëndën mësimore HISTORI për vitin III- rë në arsimin e mesëm profesional katërvjeçarë për vitin shkollorë 2020/2021 e miratoi

Ministri

Mila Carovska